



Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28 e datës 04 qershor 2008, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 7 paragrafi 1, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1, nenit 12, nenit 13 dhe nenit 14 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Prcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.04.2026, pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

V E N D I M

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME-LOKALEVE AFARISTE TË KOMUNËS NË ZONAT KADASTRALE LIPJAN

Neni 1

Me këtë Vendim jepen në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik paluajtshmeritë-lokalet afariste që gjinden në Zonat Kadastrale Lipjan, të paraqitura në tabelën si në vijim:

Nr	Njësit kadastrale	Adresa	Kati	Nr.i lokalit	Sipërfaqe m ²
1	1920-0	Rr.Lidhja e Prizerenit" pjesa verilindore në Lipjan	I	2	43m ²
2	1920-0	Rr.Lidhja e Prizerenit" pjesa verilindore në Lipjan	I	3	25m ²
3	1920-0	Rr.Lidhja e Prizerenit" pjesa verilindore në Lipjan	I	4	50m ²
4	1920-0	Rr.Lidhja e Prizerenit" pjesa verilindore në Lipjan	I	5	42m ²

Neni 2

1. Sipas nenit 1 të këtij Vendimi lokalet afariste jepen në shfrytëzim në periudhen afatshkurtër prej 10 (dhjetë) viteve, nëpërmjet ankandit publik nga ana e Komisionit Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal.
2. Sipas pikes 1 të nenit 2 këtij Vendimi pronat-lokalet afariste ipen në shfrytëzim me çmimin fillestar prej 4€ (katër euro) për m² në ngarkes mujore, për secilin lokal afarist, duke u bazuar në vendndodhjen e lokalit, ndërsa do të kenë mundësi të përfitojnë personat fizik dhe juridik që ofrojnë çmimin më të lartë në ankand publik.
3. Lokalet afariste të propozuara janë publikuar brenda afatit ligjor në ueb-faqen zyrtare të komunës sipas aktit të Zyrës së Kryetarit-Sektori Pronësor-Juridik 1Nr.01-463/02-70853 datë 30.12.2025 të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues 2026 konform dispozitave të nenit 13 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 3

1. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës siç përcaktohen në nenin të këtij vendimi, është funksionalizimi i lokaleve afariste komunale dhe krijimi i të hyrave vetanake të komunës.
2. Interesi ekonomik i komunës nga dhënia në shfrytëzim e lokaleve të cekura afariste është përfitimi financiar nga qiraja.

Neni 4

Procedura e vlerësimit të ofertave mund të zhvillohet edhe në rastin kur paraqitet vetëm një ofertues me kushtë që të jenë plotësuar të gjitha kriteret tjera të përcaktuara në ankand.

Neni 5

Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës, të regjistroj në librat kadastral si pronë e dhënë në shfrytëzim afatshkurtër siç përcaktohet në nenin 2 të këtij vendimi në mbështetje të dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Zyra e Kryetarit-Sektori Pronësor-Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Urbanizëm Planifikim, Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspektion.

Neni 7

1.Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 15-462/01-20084

Lipjan, më 30.04.2026

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi